



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200067/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda : Rekomandim për inspektimin e kryer në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë në Tiranë.

Drejtuar : Drejtues i Parë Lorenc PANGANIKA
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Për dijeni: Drejtues Madhor Gledis NANO
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Për dijeni: Ministria e Brendshme

TIRANË

I nderuar z. Paganika,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe në nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në vendet ku privohet liria e personit, ambienti i shoqërimit dhe ambienti i sigurisë, në Drejtorinë Vendore të Policisë (DVP), Tiranë.

Inspektimi u krye në datën 21.01.2022, sipas Planit të Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit drejtohej nga Komisioneri i MKPT-së znj. Ermonela Xhafa, me përbërje z. Besnik Deda dhe z. Hazbi Selita, me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të

Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde të punës “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara në vijim:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me Drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë, Tiranë, z.Lorenc Panganika dhe Zv.Drejtorin për sigurinë publike pranë kësaj drejtorie z.Luigj Vathi, të cilët u vunë në dijeni lidhur me vizitën e inspektimit të MKPT-së në DVP Tiranë.

Qëllimi i inspektimit të MKPT-së ishte monitorimi i respektimit të situatës së të drejtave dhe lirive të njeriut, të personave të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar në flagrancë, duke përfshirë këtu kushtet infrastrukturore, respektimin e të drejtave dhe garancive procedurale të tyre të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Policinë e Shtetit, ofrimin e shërbimit shëndetësor, verifikimin e rasteve të pretenduara për ushtrim dhune, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹.

Pasi mori informacionin e nevojshëm mbi masat e marra për garantimin e të drejtave të personave dhe kushtet e krijuara në këto ambiente, grupi i inspektimit i shoqëruar nga Zv.Drejtori për sigurinë publike pranë kësaj drejtorie z.Luigj Vathi, vijoi inspektimin në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, si dhe u njoh e administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona.

Nga informacioni i mbledhur dhe inspektimi i kryer në mjediset e policisë, rezultoi se gjendja dhe kushtet e krijuara në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, në përgjithësi ishin sipas kërkesave dhe parametrave teknikë të parashikuara në procedurat standarde të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Në kuadër të verifikimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

- ✓ Ishte realizuar rekomandimi, për vënien në funksion të sistemit të ngrohjes në dhomat e sigurisë, si dhe furnizimi me ujë të ngrohtë i dusheve dhe tualeteve.

¹ Shkresë nr.K4/I17-2 prot., datë 16.09.2020 “Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë në Tiranë”.

- ✓ Ishte realizuar rekomandimi, për vendosjen e telefonit fiks në korridorin e dhomave të sigurisë për komunikimin e punonjësve të shërbimit me sallën operative në rast nevojë.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet e bëra nuk kishin gjetur ende zbatim, me argumentin se nuk ka fonde në zërin investime në buxhetin e shtetit për këtë qëllim, pasi është drejt përfundimit dhe së shpejti do të vihet në funksion të plotë blloku/godina e sigurisë për Drejtorinë dhe komisariatet e policisë në varësinë e saj në Tiranë.

Ky investim ndonëse ka përfunduar së ndërtuari sipas kontratës të lidhur ndërmjet DPSH-së dhe operatorit ekonomik "HASTOCI" shpk², **godina rezulton të mos jetë e plotësuar me të gjithë elementët e sigurisë**, që do të garantonin trajtimin dinjitoz të personave të akomoduar në këto ambiente.

Një problematikë e tillë u evidentua edhe nga Drejtori i DVP-së Tiranë, gjatë vizitës që zhvilloi në datë 11 Janar 2022 në ndërtesën/bllokun e sigurisë të kësaj drejtorie, sëbashku me Avokatin e Popullit, znj. Erinda Ballanca e shoqëruar nga Komisioneria e MKPT-së znj. Ermonela Xhafa dhe Komisioneria e Seksionit të Veçantë, znj. Ermonela Ruspi.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, mungesa e elementëve të sigurisë në godinën ku do të akomodohen personat e arrestuar/ndaluar për Qarkun e Tiranës, duhet të ishin evidentuar, si një problematikë kryesore, që në fazën e hartimit të projektit nga grupi i punës, si dhe duhet të kishin organizuar konsulta më të gjëra duke përfshirë dhe specialist të policisë në fushën e sigurisë.

Ky investim ende dhe sot nuk është bërë efektiv dhe personat e arrestuar/të ndaluar mbahen e trajtohen në dhomat e sigurisë të komisariateve të policisë në Tiranë, të cilat janë konsideruar nga KPT³ si të papërshtatshme pasi nuk përmbushin standardin e trajtimit njerëzor e me dinjitet të personave të ndaluar apo arrestuar, në shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut⁴, ku thuhet shprehimisht se: *"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese"*.

Ndaj në këto kushte, drejtuesit e policisë në nivel qendror dhe atë vendor, duhet të nxisin hapat dhe procedurat për pajisjen e menjëhershme të bllokut të sigurisë të DVP Tiranë me të gjithë elementët e sigurisë të nevojshëm, me qëllim që ky objekt të bëhet funksional sa më parë, që do të rrisë në nivel më të lartë garantimin e të drejtave dhe lirive të personave të arrestuar apo të ndaluar. Njëkohësisht, duhet të nxirren edhe përgjegjësitë administrative dhe të merren masa disiplinore për personat e përfshirë në grupet e punës për hartimin e këtij projekti me rëndësi.

Situata e rekomandimeve të pazbatuara paraqitej si më poshtë vijon:

² Afati për ndërtimin e zonës së Sigurisë në DVP Tiranë ishte 24 muaj, sipas kontratës nr.1412, datë 14.08.2019 me operatorin ekonomik "HASTOCI" shpk.

³ Raporti CPT botuar më 17 shtator 2019. <https://rm.coe.int/168097986b>

⁴ https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf

- ✓ Nuk ishte realizuar rekomandimi, për krijimin e dhomës (zyrës) ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit me kamera audio-video.
- ✓ Nuk ishte realizuar rekomandimi, për shtimin në organikë të mjekut me kohë të plotë në DVP Tiranë, për shkak të dinamikës dhe numrit të lartë të komisariateve në varësi të saj.
- ✓ Nuk ishte realizuar rekomandimi, për instalimin në dhomat e sigurisë të butonit me zile/sinjali për kontaktin e të ndaluar/arrestuarve me punonjësin e shërbimit të policisë.
- ✓ Nuk ishte realizuar rekomandimi, për ruajtjen e pamjeve filmike në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, për arsye të mungesës të aparateve të regjistrimit.

Theksojmë se, gjatë kryerjes të inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë të kësaj drejtorie, drejtuesit dhe punonjësit e policisë të të gjitha niveleve, u treguan bashkëpunues dhe transparentë me grupin e inspektimit.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre.

Ambienti i shoqërimit në DVP Tiranë, ishte i ndërtuar përgjithësisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhër nr.938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ai përbëhej nga 3(tre) dhoma shoqërimi, përmasat teknike të secilës dhomë ishin 5x5 m, me sipërfaqe dhe hapsira të bollshme, si dhe të kompletuara me karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar. Dhomat e shoqërimit ishin të ndara më vehte një dhomë për personat e rritur, një dhomë për gratë dhe një dhomë për të miturit në konflikt me ligjin, sipas akteve ligjore në fuqi.

Dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me orënditë e nevojshme si tavolinë pune dhe nga 5 karrige në secilën dhomë, në total për akomodimin e 15 personave. Dritaret në dhomat e shoqërimit kishin përmasa të tilla, që mundësonin ajrim dhe ndriçim natyral të plotë. Në pjesën e jashtme ato ishin të siguruara me rrjetë hekuri, me qëllim ruajtjen fizike të personave të shoqëruar. Dhomat e shoqërimit kishin dhe ndriçim artificial, që furnizoheshin nga rrjeti elektrik dhe nga gjeneratori, në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Brenda këtij mjedisi, ngjitur me dhomat e shoqërimit, ndodheshin dhe dy tualete të ndara më vehte për gra dhe për burra. Ato ishin të pajisura me nyje hidrosanitare dhe furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm nga rrjeti i UK Tiranë, pa ndërprerje përgjatë 24 orëve.

Në momentin e inspektimit dhomat e shoqërimit dhe tualetet **nuk** ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. U konstatuan mure të zhgarravitura dhe me njolla të ndryshme, si dhe papastërti në dysheme dhe kryesisht në pjesën e dritareve.

Sikurse u evidentua nga informacioni i drejtuesve të policisë, në mjedisin e shoqërimit **mungon** një dhomë për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar. Aktualisht, intervistimi dhe marrja në pyetje e këtyre personave zhvillohet në zyrat e punës të punonjësve të policisë, në shkelje të kërkesave për kushtet e mbajtjes dhe sigurisë të personave të shoqëruar të parashikura në procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, ku thuhet shprehimisht se: “*Në mjediset ku pyetet i shoqëruari të kenë të vendosura pajisje e orendi pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si; tavolina e karrige si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme*”⁵.

Gjithashtu, intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin dhe shoqërohen në mjediset e kësaj drejtorie, kryhet në zyrat e punës të punonjësve të policisë, por sipas dokumentacionit të verifikuar që mbahej nga psikologjia e DVP Tiranë, rezultoi të ishte prezent bashkë me kujdestarit ligjor të fëmijës dhe avokatin mbrojtës.

Në ambientin e shoqërimit, u evidentua se **nuk** janë të instaluara kamerat e sigurisë për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe hyrjes për në dhomat e shoqërimit, të cilat duhet të monitorojnë veprimet e punonjësve të policisë gjatë kryerjes së procedurave me personat e shoqëruar brenda mjediseve të policisë.

Nga inspektimi në ambientin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla, që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në momentin e inspektimit, në regjistrin e shoqërimit ishin të evidentuar 9(nëntë) persona, me të cilët po kryheshin veprime proceduriale nga punonjësit e policisë, për intervistimin dhe marrjen në pyetje. Të shoqëruarit ishin në moshë madhore. Ndërsa, për periudhën 01-21 Janar 2022 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 196 persona të shoqëruar, nga të cilët 6 (gjashtë) ishin gra dhe vetëm një ishte i mitur. Sipas këtyre statistikave, rezultoi se dhomat e shoqërimit kanë qenë me mbipopullim, çdo ditë të muajit janar 2022.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Ambienti i sigurisë në DVP Tiranë, ishte i ndërtuar përgjithësisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurën standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

⁵ Pika 4, kreu VII “Zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar”.

Ai përbëhej nga 8 (tetë) dhoma për akomodimin e personave të arrestuar/ndaluar, 1 (një) dhomë e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, e cila shërben njëkohësisht dhe si dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku, 1 (një) dhomë për intervistimi/marrjen në pyetje nga përfaqësuesi i organit të akuzës dhe për takim me avokatin mbrojtës të të ndaluar/arrestuarve, si dhe një ambient i përbashkët dushi dhe tualeti.

Dhomat e sigurisë ishin të ndara më vete 6 për meshkuj madhorë, 1 për gratë dhe 1 për të mitur, persona në cilësinë e të arrestuarve apo të ndaluarve, për të cilët oficerët e policisë gjyqësore kanë marrë masën e arrestimit/ndalimit, sipas Kodit të Procedurës Penale. Kapaciteti fizik i dhomave të sigurisë ishte për **mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e 10 personave.**

Sipërfaqet dhe hapsirat në dhomat e sigurisë ishin të bollshme për të përballuar kapacitetin fizik, referuar kjo përmasave që kanë dhomat e sigurisë dhe numrit të shtretërve të vendosur në secilën dhomë. Ato ishin të kompletuara me orenditë e nevojshme si krevat, dyshekë, jastek dhe batanije. Sistemi i ngrohjes në dhomat e sigurisë ishte i vjetëruar, por ishte ndërhyrë për riparimin e tij dhe aktualisht ishte në gjendje pune.

Në momentin e inspektimit në dhomat e sigurisë, u konstatua se ndodheshin 27 persona në cilësinë e të arrestuarve dhe të ndaluarve, me një **mbipopullim 17 persona** mbi kapacitetin fizik të këtyre dhomave. Për shkak të mbipopullimit, u konstatua se në dhomat e sigurisë ishin akomoduar 4-5 persona, ku pjesa më e madhe e personave flinin me dyshekë të vendosur në dysheme.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mënyrë të përsëritur ka konstatuar mbipopullim në dhomat e sigurisë të DVP Tiranë, gjatë viteve 2020 dhe 2021, kryesisht pas protestave të qytetarëve të zhvilluara në Tiranë. Në përfundim të inspektimeve të kryera nga ekspertët e institucionit, është konkluduar se kushtet fizike dhe mbipopullimi, përbëjnë elementë të trajtimit ç'njerëzor dhe degradues, referuar edhe standardeve të parashikuara në dokumentat ndërkombëtare dhe jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut për këtë qëllim.

Në këto kushte, zgjerimi i kapaciteteve të dhomave të sigurisë në DVP Tiranë dhe komisariatet e policisë, është nevojë e menjëhershme. Blloku i ri i sigurisë i ndërtuar për këtë drejtori, duhet të përfundojnë sa më shpejtë dhe të vihen në funksion ambientet e dhomave të sigurisë, të cilat garantojnë trajtim dinjitoz dhe rrisin sigurinë fizike të personave të arrestuar/ndaluar, sipas standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Pavarësisht investimit të ri, rezulton se situata e dhomave të sigurisë për personat e arrestuar/të ndaluar, në komisariatet e DVP Tiranë, nuk u përgjigjet nevojave në rritje të tyre, për shkak dhe të rritjes së numrit të banorëve në Tiranë. Në këto kushte, duhet bërë një studim më konkret për rritjen e kapaciteteve të ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë në kryeqytet dhe për pajisjen e tyre me orenditë e nevojshme, për të lehtësuar punën e

specialistëve të policisë, për qëndrimin ulur të personave, si dhe për akomodimin e tyre, sipas standardeve të kërkuara.

Grupi i inspektimit, në bazë të metodologjisë të inspektimit, zhvilloi intervista konfidenciale me personat e arrestuar/ndaluar që ndodheshin në dhomat e sigurisë. Nga intervistat, rezultuan se në dhomat e sigurisë ndodheshin dy persona të ndaluar, të cilët ishin dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, por kishin 12 ditë që qëndronin në këto ambiente në pritje për t'u transferuar në një nga IEVP-të, në varësi të kapaciteteve akomoduese.

Në DVP dhe komisariatet e policisë në Tiranë, transferimi i vonuar dhe tej afateve ligjore i personave, që kanë marrë masën e sigurimit ose personave të dënuar me burg, pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) përkatëse, vijon të mbetet një problematikë e pazgjidhur në vite.

Nga inspektimet e mëparshme të institucionit të Avokatit të Popullit, rezulton se periudha e qëndrimit të këtyre shtetasave në drejtorinë/ komisariatet e policisë Tiranë, varion nga 6-7 ditë deri në transferimin e tyre në IEVP, ndërkohë që mungojnë kushtet minimale të akomodimit të këtyre shtetasve qoftë edhe për pak ditë. Kjo praktikë, përbën një shkelje të rëndë të të drejtave që gëzojnë personat e dënuar me vendime të formës së prerë nga gjykata, të cilët duhet të vuajnë dënimin në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale dhe jo në dhomat e sigurisë të policisë së shtetit.

Nga verifikimi i disa praktikave, rezultoi se njoftimi për transferimin e këtyre personave në IEVP ishte dërguar nga strukturat e policisë të DVP-së Tiranë, brenda datës së ndalimit të tyre, por Drejtoria e Përgjithëshme e Burgjeve (DPB) nuk ishte përgjigjur në kohë kërkesës së këtij institucioni.

Këto raste vërtetojnë se, marrëveshja e bashkëpunimit midis institucionit të Prokurorisë së Përgjithëshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për pranimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të personave me masë sigurie "arrest me burg" dhe transferimin e të dënuarve me burgim deri në përfundim të vendimit, jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së kërkesës nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit, nuk zbatohet dhe ka mbetur një akt në letër. Kjo situatë, sjell si pasojë mbipopullimin në dhomat e sigurisë të drejtorisë dhe komisariateve të policisë në Tiranë, për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme.

Lidhur me këtë konstatim të bërë nga Avokati i Popullit, por dhe nga KPT pas përfundimit të vizitës në Shqipëri nga data 20-30 Nëntor 2018⁶, autoritetet shtetërore përgjegjëse kanë informuar për zbatimin e këtyre rekomandimeve duke u shprehur se, procedurat dhe afatet për transferimin e të burgosurve të dënuar me vendim të formës së prerë nga Policia e Shtetit në ambientet e IEVP-ve, përcaktohen në Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis Prokurorisë së Përgjithëshme dhe Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve me nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 "Për transferimin në IEVP të të paraburgosurve

⁶ Raporti i CPT-2019, Faqe 8 link: <https://rm.coe.int/16809cb571>

me masën e sigurisë “paraburgim” dhe të dënuarit me burgimi me vendim përfundimtar në mungesë”. Por, sikurse rezultoi nga inspektimi, kjo marrëveshje nuk po zbatohet në mënyrë efektive nga institucionet e përfshira në këtë marrëveshje, si dhe në përputhje me qëllimin e saj, për t'i dhënë fund praktikës së mbajtjes në polici të personave me masë sigurie "arrest me burg" dhe të dënuarve me burgim me vendim të formës së prerë.

Nga sa më sipër, rezulton gjithashtu qartë që kjo situatë tregon edhe për moszbatim të masave anti COVID, duke rrezikuar shëndetin e personave të arrestuar/ të ndaluar që qëndrojnë në këto ambiente, si pasojë e mbipopullimit të kësaj kategorie personash.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, e cila përdorej njëkohësisht edhe si dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku i DVP Tiranë. Krahas orendive si tavolinë pune dhe raftit për mbajtjen e dokumentacionit dhe regjistrave të shërbimit, në këtë ambient ishin të vendosura dhe orenditë e nevojshme për ushtrimin e detyrës të mjekut si krevat, tavolinë, karrige, rafte për mbajtjen e ilaçeve dhe pajisje për ngrohje.

Pavarësisht funksionit që ka, kjo dhomë është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në procedurën standarde, pasi dhoma e mjekut duhet të jetë si ambient më vete dhe vetëm për personelin mjekësor.

Brenda ambientit të sigurisë, ndodhej dhoma e marrjes në pyetje të personit nga OPGJ, si dhe për takim me avokatët e të ndaluar/arrestuarve, e cila ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme. Dhoma ishte monitoruar me sistemin e kamerave të sigurisë audio-vizive, por nga informacionet e dërguara nga DVP Tiranë dhe DPSH, në të gjitha strukturat e policisë Tiranë, **mungojnë aparatet për regjistrimin e pamjeve filmike**, për të vëzhguar veprimet që kryejnë përfaqësuesit e organit të akuzës gjatë marrjes në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar.

Sistemi i kamerave ishte i instaluar edhe në ambientin e jashtëm të dhomave të sigurisë, për të garantuar ruajtjen fizike të këtij ambienti, si dhe në korridorin e dhomave të sigurisë.

Në korridorin e dhomave të sigurisë ndodhej një telefon fiks për komunikim të punonjësve të shërbimit me sallën operative në rast nevojë, ndërsa në dhomat e sigurisë **nuk** janë të instaluar butoni me zile/sinjali për kontaktin e të ndaluar/arrestuarve me punonjës të policisë.

Ambienti ku ndodhej dushi me ujë të ngrohtë për larjen e trupi dhe tualetet, ishte i pajisur me nyje hidrosanitare dhe furnizohej me ujë të rrjedhshëm, nga rrjeti i UK Tiranë.

Ambineti i sigurisë ishte i lidhur me një gjenerator, i cili shërbente si burim alternativ rezervë për ndriçim, në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Gjatë inspektimit, në ambientet dhe dhomat e sigurisë, nuk u gjetën sende që shkaktajnë/eksponojnë dhunë psikologjike tek të ndaluarit/arrestuarit.

Kushtet higjeno-sanitare në dhomat e sigurisë ishin të përkeqësuar, ato nuk ishin të pastra dhe të lyera. Për shkak të mbipopullimit, u gjetën në dysHEME produkte ushqimore të konsumuara dhe të hedhura në tokë, si dhe konsumi i duhanit në disa nga dhomat kishte rënduar ambientin dhe dëmtonte shëndetin e personave të tjerë.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë, të dhënat për personat e shoqëruar regjistrohen në *“Regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”*, i cili ishte i hapur sipas modelit 1 të përcaktuar në procedurën standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*⁷.

Në momentin e inspektimit u konstatua se, regjistri i të shoqëruarve **nuk** ishte i plotësuar sipas rubrikave për personat që ndodheshin në cilësinë e të shoqëruarve në mjediset e drejtorisë së policisë. Lidhur me këtë konstatim të grupit të inspektimit, personeli që kryente shërbim në ambientin e shoqërimit, u justifikua se punonjësit e policisë që kishin kryer shoqërimin e këtyre personave në polici, **nuk** kishin plotësuar ende *“Formularin e Raportit të Shoqërimit”*, sipas kërkesave që parashikohen në procedurën standarde për këtë qëllim, ku thuhet se: *“Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, menjëherë pas shoqërimit të personit në ambientet e policisë/ambientet e shoqërimit”*⁸.

Ndërkohë, personat e shoqëruar kishin mbi 2 orë që ndodheshin në cilësinë e të shoqëruarve në mjediset e kësaj drejtorie dhe në regjister ishin hedhur vetëm të dhënat me emër dhe mbiemër për këta persona, **ndërsa rubrikat e tjera ishin akoma të pa plotësuar**.

Ky konstatim, përbën shkelje të të drejtave, që gëzojnë personat e shoqëruar në mjediset e policisë, pasi punonjësi i shërbimit të informacionit nuk duhet të pranojë dhe nuk duhet të marrë në dorëzim personin e shoqëruar, pa u plotësuar dhe dorëzuar formulari i raportit të shoqërimit nga punonjësit e policisë që kanë kryer shoqërimin e personit.

Në vijim të procedurave, punonjësi i policisë duhet ti njoh personat e shoqëruar me kartën e të drejtave që ju njeh ligji, e cila parashikon të drejtën për të kërkuar avokat mbrojtës (nëse e dëshiron), e drejta për të njoftuar familjarët e tij lidhur me faktin e shoqërimit dhe të vendndodhjes, si dhe për të kërkuar shërbim shëndetësor (nëse është e nevojshme prej tyre).

⁷*“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, kreu VIII *“Procedura të dokumentimit të veprimtimit të shoqërimit”*, pika a.1.2, *“Regjistri i evidentimit të personave të shoqëruar”*.

⁸*“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, kreu VIII *“Procedura të dokumentimit të veprimtimit të shoqërimit”*, pika a.2, *“Formulari i Raportit të Shoqërimit”*.

Më tej, pasi njihet me të drejta e tij, personi i shoqëruar ka të drejtë që të njihet edhe me arsyet e shkaqet e shoqërimit nga punonjësi i policisë i ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale.

Plotësimi në kohë i regjistrit me të dhënat e personave të shoqëruar, është një problem i hasur edhe gjatë inspektimeve, që kanë kryer ekspertët e institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë monitorimit të protestave të zhvilluara në Tiranë. Por, justifikimi i punonjësve të policisë në ato momente ka qenë fakti se, numri i personave të shoqëruar në këto ambiente, ka qenë i lartë. Institucioni i Avokatit të Popullit, ka sygjëruar që në rastet e protestave kur mendohet se ka një numër të shtuar të personave të shoqëruar në mjediset e policisë, drejtuesit e policisë të planifikojnë personel shtesë në ambientin e shoqërimit, që të merren në mënyrë të veçantë me pritjen e tyre, trajtimin njerëzor dhe dinjitoz të tyre, evidentimin e të dhënave të personave në regjistër në një kohë sa më të shpejtë, si dhe kryerjen e veprimeve procedurale duke respektuar në çdo rast afatin kohor deri në 10 orë të shoqërimit.

Nga këqyrja e regjistrit të personave të shoqëruar për periudha të mëparshme, rezultoi se rubrikat e tij ishin plotësuar në rregull në pamje të parë, por është evidente se ato nuk plotësohen në dinamikë, por post faktit. Koha e qëndrimit të shtetasve në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Për personat që dyshoheshin për vepra penale, koha e shoqërimit mund të shkojë deri në 12 orë, me qëllim mbledhjen e provave sipas Kodit të Procedurës Penale.

Për personat e arrestuar/ndaluar, të dhënat e tyre evidentoheshin në regjistrin e miratuar sipas modelit të përcaktuar në procedurën standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij dhe ishte i sekretuar.

Nga krahasimi i dy regjistrave, si dhe nga verifikimi i procesverbalit të arrestimit në flagrancë apo urdhri i ndalimit të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore (prokurori) për personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit, u evidentua se koha e arrestimit apo ndalimit të të shoqëruarve përputhej me kohën e shoqërimit të tyre në mjediset e DVP Tiranë.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë

Në kohën e inspektimit, në ambientin e shoqërimit të DVP-së, Tiranë, ndodheshin 9 (nëntë) persona në cilësinë e të shoqëruarve. Ndërsa në ambientin e sigurisë ndodheshin 27 (njëzet e shtatë) persona në cilësinë e personave të arrestuar/ndaluar, nga të cilët 1 (një) grua dhe 1(një) i mitur.

Nga intervistimi i personave të arrestuar/ndaluar, grupi i inspektimit konstatoi se ata ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në dhomat e sigurisë. Të intervistuarit nuk kishin pretendime për trajtim denigrues, jo human, apo për ushtrim të dhunës fizike e psikologjike, por gjendja e mbipopullimit në dhomat e sigurisë përbënte trajtimi jo dinjitoz të tyre.

Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi për shkak të veprimeve të kundraligjshme të punonjësve të policisë, por situata e mbipopullimit ishte shkaku kryesor dhe i drejtpërdrejtë që kishte sjellë si pasojë trajtimin jo dinjitoz të këtyre personave.

Të intervistuarit nuk dëshmuuan frikë apo druajtje për të raportuar nëse ishin keqtrajtuar. Shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet procedurale. Ata shpjeguan se, gjatë ndalimit/arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Koha e qëndrimit e të arrestuarve në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor dhe ishin në pritje të vleftësimit të masës të sigurisë nga ana e gjykatës sipas procedurës të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale. Ndërsa, dy personat e ndaluar për shkak të vendimit të formës së prerë të gjykatës, kishin 12 ditë që qëndronin në ambientin e sigurisë, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk kishte kthyer përgjigje shkresës të DVP Tiranë për transferimin e tyre në një nga I EVP-të.

Në DVP Tiranë, sikurse dhe në komisariatet e policisë që kanë dhoma sigurie, mungon ambienti i ajrimit⁹, i cili shërben për nxjerrjen në ajrim të personave sipas orarit të veprimeve, si dhe mund të shërbejë njëkohësisht dhe si ambient ku mund të konsumohet duhani për ata persona që e pijnë atë dhe të ndalohet kategorikisht konsumi i duhanit në dhomat e sigurisë, pasi dëmton shëndetin e personave të tjerë.

Nga informacioni i drejtuesve të policisë, por edhe nga intervistat e zhvilluara me personat e arrestuar/ndaluar, rezultoi se në dhomat e sigurisë personat trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë, sipas normativave të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej dhe servirej me shërbim “catering”, nga një subjekt privat me të cilin ishte lidhur kontratë nga DVP Tiranë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

⁹ *Kreu VII, pika 6 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Ambientet e intervistimit

Në dhomat e shoqërimit të DVP-së Tiranë, **nuk** ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një veprë penale. Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësit të policisë.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personit në një ambient më vete që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Ndërsa në dhomat e sigurisë kishte një dhomë më vete, e cila shërbente për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesi i organit të akuzës, si dhe për takime me avokatët mbrojtës. Kjo dhomë ishte e monitoruar me sistemin e kamerave të sigurisë audio-video.

Grupi i monitorimit, inspektoi zyrat e punës të punonjësve të policisë që kryenin veprime procedurale me personat e shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar. Nga monitorimi, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj personave me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Nga inspektimi në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në DVP Tiranë, grupi i inspektimit konstatoi se në korridoret dhe pranë dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, por ato kishin nevojë të rifreskohen me të reja. Gjithashtu, afishimi i të drejtave duhet të bëhet dhe në vende të tjera të aksesueshme nga personat që ndodhen në mjediset e policisë, me qëllim për të dhënë mundësinë e leximit dhe kuptimit të këtyre të drejtave nga ana e tyre.

Gjatë intervistave të zhvilluara me personat që ndodheshin në mjediset e privimit të lirisë të kësaj drejtorie, ata pohuan se ishin njohur me të drejtat e tyre ligjore nga punonjësit e policisë kur ishin marrë në pyetje.

Nga intervistimi i personave të arrestuar/ndaluar dhe personave të shoqëruar, u evidentua se, punonjësit e policisë i kishin njohur me të drejtën për të patur avokat mbrojtës, nëse

ata e kërkonin vetë para se të merreshin në pyetje. Gjithashtu, ata u kishin krijuar mundësinë edhe për të kontaktuar me ta.

Ndërsa, personat e arrestuar/ndaluar që nuk kishin mundësi financiare për të patur avokat mbrojtës dhe kërkonin asistencë juridike, organi i prokurorisë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, ju cakton atyre avokat mbrojtës nga lista e avokatëve të miratuar prej tyre.

Kodi i Procedurës Penale në nenet 34/a, gërma “c” dhe 34/b gërma “a”, si dhe ligji “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar, në pikën 3 të nenit 109 parashikon se çdo shtetas ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin mbrojtës. Gjatë verifikimeve në regjistrat “takime me avokatin”, si dhe intervistat e zhvilluara me personat e shoqëruar/ndaluar dhe të arrestuar, u konstatua se kjo e drejtë është respektuar.

Nga intervistat u evidentua se, këta persona (të shoqëruar/arrestuar/ndaluar) kishin patur akses në ofrimin e ndihmës ligjore për sigurimin e avokatit mbrojtës. Por, ata deklarorin gjithashtu se, në rastet e avokatit të caktuar kryesisht nga organi i prokurorisë, ndihma e ofruar prej tyre nuk ishte efektive. Avokatët mbrojtës në të tilla raste, asistonin vetëm në momentin e parë të marrjes në pyetje të personit dhe në firmosjen e urdhërit të ndalimit nga OPGJ. Më tej, ata nuk e kryenin shërbimin e mbrojtësit ligjor ndaj këtyre personave, kur ata paraqiten në gjykatë për vleftësimin e masës së arrestit.

Në takimin me personat e arrestuar/ndaluar, grupi i inspektimit evidentoi se, ata ishin të pajisur nga oficerët e policisë gjyqësore me setin e dokumenteve që përmbanin, a) kopjen e procesverbalit të arrestimit në flagrancë apo urdhrin e ndalimit të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore, prokurori, urdhri i ekzekutimit të prokurorit, si dhe kopje te vendimit gjyqësor; b) procesverbalin e kontrollit personal së bashku me sendet personale të cilat janë konstatuar dhe gjetur gjatë kontrollit; si dhe c) letrën me të drejtat e tyre.

Për shtetasit e huaj të arrestuar/ndaluar komunikimi me punonjësit e policisë dhe prokurorin bëhej në gjuhën amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë, nëpërmjet avokatit apo një përkthyesi. Arrestimi apo ndalimi i tyre kryhej sipas procedurave, duke njoftuar paraprakisht zyrat konsullore të shteteve respektive. Me qëllim njohjen me të drejtat e tyre, për shtetasit e huaj ishte përkthyer deklarata me të drejtat në 10 gjuhët e huaja më të përdorura.

Grupi i inspektimit evidentoi se, nga punonjësit e policisë respektohej e drejta që gëzojnë personat në mjediset e policisë së shtetit për tu informuar për shkakun e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit. Kjo u konstatua nga intervistat e zhvilluara me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar që ndodheshin në këto ambiente në momentin e inspektimit. Personat e arrestuar/ndaluar ishin të pajisur me urdhërin e arrestimit/ndalimit, ndërsa personat e shoqëruar në përfundim të procedurave pajiseshin me kopjen e procesverbalit për shkaqet e shoqërimit, duke nënshkruar në regjistërin përkatës mbi pretendimet e tyre ndaj punonjësve të policisë.

Në lidhje me të drejtën për t'u informuar mbi të drejtën që gëzon personi gjatë shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit, grupi i inspektimit konstatoi se kjo praktikë nuk kryhej njëherësh sipas parashikimeve në ligjin "Për policinë e shtetit", i ndryshuar, në nenin 109 pika 3 dhe tek neni 34/a i Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet se shtetasit kanë të drejtën e informimit për të drejtat që ata gëzojnë.

Nëse për të ndaluarit/arrestuarit përcaktohet se duhet t'i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit të kontrollit personal dhe kopje të deklaratës për njohjen me të drejtat e tij, për personat e shoqëruar kjo praktikë kryhej vetëm verbalisht nga punonjësi i policisë, duke mos i pajisur ata me kopje të deklaratës së të drejtave që në momentin kur ata hyjnë në dhomat e shoqërimit. Çdo individ të cilit i privohet liria, për arsye të parashikuara në ligj ka të drejtë të informohet mbi të drejtat dhe arsyet e shoqërimit/ndalimit/arrestimit, **që në momentin e parë të privimit të lirisë** sikurse parashikohet në ligjin "Për policinë e shtetit", në nenin 109 pika 3 si dhe në nenin 34/a pika a K.Pr.P.

Një vëmendje të veçantë kësaj çështje i ka kushtuar edhe KPT (CPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 2018, ku në raportin përfundimtar është rekomanduar "*Sigurohuni që personat e arrestuar/arrestuar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të tyre nga liria, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë në fillim të ndalimit ose arrestimit*"¹⁰.

Në kushtet kur situata e informimit me të drejtat dhe arsyet e shoqërimit/ndalimit/arrestimit vijon të jetë e njëjtë, është e domosdoshme që me stafet e punonjësve të policisë që kryejnë shërbimin në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, të zhvillohen trajnime dhe të bëhen pjesë edhe e procedurave standarde të miratuara nga DPSH, për këtë qëllim.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe nga intervistat e zhvilluara me të arrestuarit/ndaluarit, rezultoi se vizita mjekësore nga mjeku i DVP Tiranë, ishte kryer brenda afatit 12 orë nga hyrja e tyre në dhomat e sigurisë¹¹. Mjeku ishte në organik të DVP-së Tiranë dhe ishte me kohë të plotë. Vizitat mjekësore, rekomandimet dhe mjekimet regjistroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i ambientit të sigurisë të këtij komisariati. Mjeku mbulonte ndërkohë dhe vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar në dhomat e sigurisë edhe në komisariatet e policisë në varësi të DVP-së Tiranë.

¹⁰Në lidhje me këtë rekomandim DPSH është shprehur se me anë të shkresës nr. 6104/3, datë 02.09.2019, "Për njohjen e raportit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të CPT-së për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit" është tërhequr vëmendja e të gjitha strukturave vendore të policisë dhe i është kërkuar sigurimi i informacionit verbal të qartë dhe të plotë në lidhje me të drejtat e tyre, që nga momenti i parë i privimit të lirisë, plotësimi dhe sigurimi i një kopje të formularit/deklaratës me shkrim me të drejtat dhe nënshkrimin e tyre pas njohjes.

¹¹Kreu II, pika 7/b e procedurave standarde: "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019.

Për shkak të ngarkesës, shtrirjes gjeografike të komisariateve të policisë dhe dinamikës që ka DVP Tiranë, institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar se është e nevojshme shtimi në organik i personelit të shërbimit shëndetësor, për kryerjen në kohë të vizitave mjeksore të personave të arrestuar/ndaluar në të gjitha ambientet e sigurisë që janë në varësi të kësaj drejtorie. Por, sikurse u evidentua ky rekomandim ende **nuk** është zbatuar, pasi sipas tyre me funksionimin e bllokut/godinës të re të sigurisë, dhomat e sigurisë në komisaritet që janë në varësi të DVP Tiranë, do të mbyllen dhe gjithë personeli i sigurisë, ai shëndetësor dhe psikologu do jenë të përqëndruar dhe si rezultat nuk do jetë e nevojshme shtimi i stafeve.

Në nenin 115 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht e drejta për kërkesa dhe ankesa e personave të privuar nga liria në ambientet e policisë, ku thuhet se: *“Çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë, si dhe çdo shtetas tjetër, ndaj të cilit punonjësit e policisë kryejnë veprime sipas dispozitave të këtij ligji ose që cënohen gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ka të drejtë t’u paraqesë kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore”*.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në ambientin e sigurisë ndodhej regjistri i kërkesë/ankesave, por për periudhën e inspektimit nuk ishte regjistruar asnjë ankesë. Ndërsa kërkesat e evidentuara kishin të bënin me kërkesa për avokat mbrojtës, për vizitë mjeksore nga mjeku dhe njoftimin e familjarëve. Ndërsa në ambientin e shoqërimit, nuk kishte një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave.

Personeli i shërbimit në ambientin e shoqërimit **nuk** shënonin në mënyrë të rregullt në regjistër natyrën e kërkesë-ankesave të këtyre personave, pasi sipas punonjësve të policisë, ato kryheshin në rrugë verbale. Gjithashtu, u konstatua se për pjesën dërrmuese të kërkesë nuk dokumentohej mënyra e trajtimit dhe e zgjidhjes së tyre.

Lidhur me mënyrën e evidentimit të kërkesë/ankesave të personave që shoqërohen, arrestohen apo ndalohen në mjediset e Policisë së Shtetit, institucioni i Avokatit të Popullit, sygjeron se, e drejta e paraqitjes së ankesës nga këta persona, duhet të jetë e pasqyruar në kartën e të drejtave, me qëllim për të përmirësuar sistemin e trajtimit dhe zgjidhjes në kohë të tyre, nga strukturat përgjegjëse në organet e policisë.

Në DVP Tiranë u evidentua se zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit e çështjes përkatëse.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për

Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, si dhe nenit 81, pika 2/b të ligjit 81/2020 ku përcaktohet se Mekanizmi Kombëtar ushtron këto kompetenca: “*paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës*”:

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masa të menjëhershme, për eliminimin e mbipopullimit në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë në DVP Tiranë, pasi përbën shkelje të të drejtave dhe trajtim jo njerëzor e dinjitoz të tyre.
2. Të merren masa të menjëhershme, për trajnimin e stafit të punonjësve të policisë që kryejnë shërbimin në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në DVP Tiranë, si dhe atyre që kryejnë veprime procedurale me të shoqëruarit/arrestuarit dhe të ndaluarit, me qëllim informimin me arsyet e shoqërimit/arrestimit dhe të ndalimit për njohjen me të drejtat që gëzojnë personat kur shoqërohen në mjediset e policisë, që në momentin e privimit të lirisë, sipas rekomandimit edhe të KPT-së.
3. Të merren masa të menjëhershme, për hapjen e regjistrit me qëllim evidentimin e kërkesë-ankesave të personave të shoqëruar, si dhe dokumentimin e mënyrës së trajtimit dhe zgjidhjes së tyre.
4. Të merren masa të menjëhershme, për hartimin e një plani mbi bazën e një studimi për nevojat dhe kapacitetet e akomodimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në komisaritet dhe DVP Tiranë, në përputhje me numrin e banorëve në rritje në kryeqytet.
5. Të merren masa të menjëhershme, për pajisjen e tërë personave të privuar nga liria si në cilësinë e të shoqëruarve ashtu dhe të ndaluar/arrestuarve, me kopjen e deklaratës së të drejtave që në momentin e hyrjes në mjediset e shoqërimit të drejtorisë së këtyre personave.
6. Të merren masa të menjëhershme, nga DPSH në bashkëpunim me DPB, për zbatimin e marrëveshjes midis të dy institucioneve, për transferimin brenda 24 orëve të ndalimit të personave me vendim të formës së prerë të gjykatës me masë “arrest me burg”, duke parashikuar në procedurat standarde dhe marrëveshjet e përbashkëta, mundësinë e shkëmbimit elektronik të njoftimeve dhe shkresave të këtyre organeve, për të eliminuar vonësat në transferimin në kohë të personave.
7. Të merren masa të menjëhershme për pastrimin, higjenizimin, lyerjen dhe dizifektimin e dhomave të shoqërimit dhe dhomave të sigurisë në DVP Tiranë.

8. Të merren masat e nevojshme, për krijimin e dhomës (zyrës) ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore, të arrestuar në flangracë apo të dyshuar për vepra penale, para se ata të dërgohen në ambientet e sigurisë, e cila të jetë e pajisur dhe me sistemin e monitorimit me kamerave audio-video.
9. Të merren masa për të identifikuar përgjegjësitë dhe të merren masat përkatëse nëse ka përgjegjësi administrative, për mangësitë e vërejtura në lidhje me mungesën e kushteve të nevojshme të sigurisë në ndërtesën/bllokun e sigurisë të DVP Tiranë.
10. Të merren masa të menjëhershme, për vënien sa më parë në funksion të godinës të re të sigurisë edhe pse nuk ka përfunduar paisja e saj me të gjithë elementët e sigurisë, si dhe të nxirren përgjegjësitë lidhur me mos vënien në efikasitet të godinës së re.
11. Të krijohet mundësia e ambientit të hapur të ajrimit për personat e arrestuar/të ndaluar, në godinën e re të sigurisë të DVP Tiranë, por dhe në komisariatet e policisë, sipas parashikimeve në procedurën standarde për këtë qëllim.
12. Të merren masat e nevojshme, për përshtatjen e adoptimin në ambiente shoqërimi, të dhomave që do të lirohen në komisariatet e policisë në Tiranë, si dhe pajisjen e tyre me orëditë e nevojshme, sipas kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në procedurën standarde për këtë qëllim.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brënda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA